




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARURË I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1905/598/BA/ah
Nr. 04/2019

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Avdyl Hyseni-kryetar dhe Musa Dragusha e Ilaz Rudaku-anëtarë, duke vendosur lidhur me Ankesen Nr. Ref. 1904/565/DL/az të datës 30.04.2019 e “IPKO Telecommunications” LLC, me adresë: Rr. Zija Shemsiu, nr. 34, Ulpianë, Prishtinë, përfaqësuar nga Robert Erzin, paraqitur kundër Vendimit Nr. 2016/216 të datës 29.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datë 10.05.2019 mori këtë:

V E N D I M.

I. Refuzohet si e pabazuar Ankesa Nr. 1904/565/DL/az të datës 30.04.2019 e parashtresit “IPKO Telecommunications” LLC, me adresë: Rr. Zija Shemsiu, nr. 34, Ulpianë, Prishtinë.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.2016/216 i datës 29.03.2019 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Nr.2016/216 të datës 29.03.2019, e ka urdhëruar “IPKO Telecommunications” LLC si Palë përgjegjëse, që në afat prej gjashtë (6) muajsh nga plotfuqishmëria e këtij Vendimi të mundesojë ri-rënditjen e kanaleve në listën kryesore të platformës së tyre, siç përcaktohet në nenin 16 paragrafi 3 të Rregullores KPM- 2016/01.

Po ashtu, me Vendimin e lartcekur Komisioni i KPM-së, Palën përgjegjëse e sanksionon me gjobë në vlerë prej pesë mijë (5,000) euro, në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, për shkeljet e nenit 16 paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “IPKO Telecommunications” LLC me datë 30.04.2019 ka parashtruar ankesë pranë Bordit për Ankesa, duke pretenduar se vendimi kontestues ka të meta dhe i njëjti është marrë pa bërë asnjë analizë të gjendjes faktike, me

propozim që Bordi për Ankesa të aprovojë ankesën si të bazuar në tërësi dhe të anulojë Vendimin Nr.2016/216 të datës 29.03.2019.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 10.05.2019 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese "IPKO Telecommunications" LLC", si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Nr.2016/216 të datës 29.03.2019 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar dispozitat materiale dhe procedurale që rregullojnë fushën e KPM-së.

Andaj Bordi për Ankesa, nga të theksuarat me lartë e bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores Nr. BA 2017/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.


UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Avdyl Hyseni


Kryetar i Bordit për Ankesa